

DREJTIMET KRYESORE TË PUNËS PËR VITIN SHKOLLOR 2010-2011.

Sektori i Kurrikulës dhe Cilësisë ,i ngarkuar në pikëpamje administrative si një sektor me potencial zhvillues dhe monitorues nënkupton realizimin e një sërë aktivitetesh,që kanë për qëllim rritjen e performancës dhe nivelit të mësimdhënies dhe të drejtimit të shkollës nga ana e mësuesve dhe drejtuesve,

DREJTIMET KRYESORE

- Garanton zbatimin me përpikmëri të udhëzimeve të MASH-it .
- Ndjek realizimin e politikave rajonale në përputhje dhe në zbatim të Strategjisë Kombëtare të zhvillimit të arsimit.
- .
- Ndjek realizimin cilësor dhe sasior,në përputhje me aktet ligjore dhe udhëzimet e MASH-it,si dhe në përshtatje me procedimet e reja kurrikulare dhe didaktike.
- Përcaktimi i detyrave që dalin nga Udhëzimi Nr 31.dt 04.08.2011“Për strukturën dhe planet mësimore në arsimin parauniversitar për vitin shkollor 2011-2012 dhe mbarëvajtjen e punës mësimore edukative
- Ndjek me një vëmëndje të veçantë dhe me përparësi arsimin profesional, duke marrë të gjitha masat për shtimin e kontigjentit të nxënësve në këto shkolla .
- Ndjek me përgjegjësi dhe korrektësi përzgjedhjen e tekstit shkollor në nivel qarku,duke zbatuar hap pas hapi rregulloren e Altertekstit ,duke zbatuar të gjitha procedurat deri në pajisjen e çdo nxënësi me tekstet shkollore.
- Bashkëpunon me IZHA,MASH,OJQ ,ZA si edhe me sektorët e tjerë pranë DAR, për zhvillimin e aktiviteteve monitoruese dhe trajnuese në bazë shkolle,grup shkollash, DAR .
- Zbatimin e projektit “Arsimi cilësor për të gjithë ,pjesë themelore e të cilit është Plani vjetor i shkollës ,i fokusuar në arritjet e nxënësve dhe Objektivave minimale të domosdoshëm të të nxënësve (OMDN),plotësimi i të cilave ka për qëllim reduktimin e braktisjes së fshehtë .
- Krijimin e një Database- i të detajuar të të gjithë mësuesve në shkallë qarku,sipas profileve të tyre ,me qëllim planifikimin e aktiviteteve për trajnime,sipas nevojave .